



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr 18843 prot.

Shkodër, me 20.09.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin: “Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____ . _____ .2024

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve”.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat, në koordinim të ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse në mbështetje të bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese. Kjo, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një praktikë e mirë të cilën parashikon ta zbatojë në vitet në vazhdim, për disa sektorë të ekonomisë.

Ne synojmë të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t’i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të NVM-ve një vlerë të shtuar në treg. Një qasje e tillë quhet eko-inovacion dhe promovon qëndrueshmërinë gjatë gjithë ciklit jetësor të një produkti, duke filluar nga sigurimi i lëndës së parë, prodhimin, shërbimin, shpërndarjen, përdorimin e produktit dhe asgjësimin e tij. Inovacioni apo risia konsiston në zbatimin e një produkti të ri, përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve ose proceseve, krijimin e një metodë të re marketingu apo një metodë të re organizative në praktikën e biznesit, me kushtin që veprimtaritë e propozuara të kenë një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka parashikuar krijimin e një skeme financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

Kjo në zbatim të funksioneve dhe kompetencave të veta, të përcaktuara në nenin 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr.55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024–2026, të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr.398, datë 24.4.2024 “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve brenda të njëjtit program si dhe fish projekti P04130.Q1.O3.A4, skemë granti për të rinjtë të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; kërkesës nr.14670.prot, datë 11.07.2024 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: ‘Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin Krijimi i një skemë garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante;“Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.10491/2.prot, datë 22.08.2024 me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore, administruar në Bashkinë Shkodër me nr.prot.121, datë 30.07.2024”;

Projekt vendimi i propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak ka për qëllim të promovojë një model të qëndrueshëm dhe transparent, të orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe të bazuar në projekte për financimin e individëve që kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër.

Fondi total i Skemës së Granteve është **4.600.000 lekë**, dhe financohet plotësisht nga Bashkia Shkodër.

Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 800 000 lekë.

Granti do të mbështesë *të rinjtë e moshës 18- 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eko-inovative*, për një projekt propozim me afat nga 6 - 9 muaj dhe shuma do shpërndahet në bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 80% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikuesi në masën 20% të vlerës së projektit. Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare.
- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% të fondeve, duhet të parashihen për aktivitete e projektit dhe deri në 10% e fondit duhet të përdoret për reklamë/dukshmëri.
- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve. Pra nëse një biznes zgjidhet fitues dhe financohet, ai/ajo nuk mund të aplikojnë në thirrjen që do të shpallet në vitin pasardhës nga Bashkia Shkodër.

Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër. Bashkia ka të drejtë të mos ndajë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

Bashkia Shkodër do të krijojë dhe fuqizojë mekanizmat monitorues të aktiviteteve dhe rezultateve të projekteve të zbatuara nga bizneset e shpallura fituese. Njëkohësisht përveç mbështetjes financiare, Bashkia Shkodër do të zbatojë një program aftësimi i cili do të përfshijë dhënien e asistencës teknike dhe trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të tyre.

Bashkëlidhur këtij relacioni po ju dërgojmë Udhëzuesit të aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!


KRYETAR

Benq Beçi



Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Belum Nema 

Stela Qeremisi 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____. _____. 2024

PËR

“MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË APLIKIMIT PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË GRANTEVE”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____. _____. 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr.55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024 – 2026, të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr.398, datë 24.4.2024 “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve brenda të njëjtit program si dhe fish projekti P04130.Q1.O3.A4, skemë granti për të rinjtë të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; kërkesës nr.14670.prot, datë 11.07.2024 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: ‘Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin Krijimi i një skemë garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; “Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.10491/2.prot, datë 22.08.2024 me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore, administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot. 121, datë 30.07.2024”; relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik nr. _____, datë ____/____/2024;

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzuesin e Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve”, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv/Kryetar

Enirol Bajleri

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Enirol Bajleri

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik

Bekim Nana

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Skela Haradinja

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Jeni Dusha

Drejtoria Juridike

B. Dusha